

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7819
E mërkurë, 26 qershor 2024
Çmimi 0.50 €

BQK-ja publikon
statistikat e muajit
maj: 232.94 milionë euro
kredi të reja | FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PAS NËNTË MUAJSH TENSIONE, KURTI DHE VUÇIQI PËRBALLË NJËRI-TJETRIT | FAQE 4



Për herë të parë pas më shumë se nëntë muajsh kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër

Vuçiq, do të takohen më 26 qershor në Bruksel për të zhvilluar, sipas Bashkimit Evropian, një raund të ri

bisedimesh për normalizim të marrëdhënieve. Takimi i fundit mes tyre, më 14 shtator 2023, pati përfunduar pa ndonjë pajtim

AKTUALE



GJNP-JA LËSHON FLETARRESTIME
PËR SHOIGUN DHE GERASIMOVIN | F. 2

BERISHA, DEMOKRATËVE:
KTHEHUNI NË SHTËPINË
TUAJ, DUHET NJË FRONT
I GJERË OPOZITAR | F. 5

GJYKATA UA VAZHDON
PARABURGIMIN TRE TË DYSHUARVE
PËR VRASJEN E LIRIDONA MURSELIT | F. 6

EKONOMI



AKP-JA OFRON PËR SHITJE 47
LOKALE E PRONA ATRAKTIVE NË DISA
RAJONE TË KOSOVËS | F. 8

MBYLLEN MBI 30 QENDRA MASAZHI
DHE LOKALE ME MUZIKË NATE | F. 8

SPORT



SHQIPËRIA KRENOHET ME PARAQITJET
NË 'EURO 2024' | F. 10

**PDK-ja:
QEVERIA
KURTI PO E
SHKATËRRON
ADMINISTRATËN
PUBLIKE | F. 3**



**TRAFIKIMI I
QENIEVE NJERËZORE,
DASH-I JEP
REKOMANDIME
PËR KOSOVËN DHE
SHQIPËRINË | F. 7**



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

GjNP-ja lëshon fletarrestime për Shoigun dhe Gerasimovin



HAGË, 25 QERSHOR - Gjykata Ndërkombëtare Penale (GjNP) ka lëshuar fletarrestime për ish-ministrin rus të Mbrojtjes, Sergei Shoigu, dhe gjeneralin rus Valery Gerasimov, të dyshuar se kanë kryer krime gjatë pushtimit rus të Ukrainës.

Muajin e kaluar Shoigu u largua nga pozita e ministrit të Mbrojtjes dhe u emërua sekretar në Këshillin e Sigurisë së Rusisë. Ky ishte ndryshimi më i madh që presidenti rus Vladimir Putin ka bërë në komandën ushtarake që kur ka nisur luftën kundër Ukrainës më 2022.

GjNP-ja, që ka selinë në Hagë, tha se Shoigu dhe Gerasimov

dyshohen se kanë kryer krime lufte dhe krime kundër njerëzimit për shkak se kanë urdhëruar sulme ndaj civilëve dhe objekteve civile në Ukrainë.

Gjykatësit gjetën "bazë të arsyeshme për të besuar se dy të dyshuarit kanë përgjegjësi për sulmet ajrore të kryera nga forcat e armatosura ruse kundër infrastrukturës energjetike ukrainase nga të paktën 10 tetori i vitit 2022 deri më 9 mars 2023", u tha në njoftimin për medie të GjNP-së.

Rusia, që nuk është anëtare në GjNP, vazhdimisht ka thënë se infrastruktura energjetike e Ukrainës është cak legjitim

ushtarak dhe ka mohuar se shënjestron civilët apo infrastrukturën civile. Po ashtu, as Ukraina nuk është anëtare, por i ka dhënë GjNP-së juridiksion për t'i ndjekur krimet e kryera në territorin e saj.

Fletarrestimet për Shoigun dhe Gerasimovin bëjnë që numri i përgjithshëm i fletarrestimeve kundër zyrtarëve të lartë rusë që nga nisja e pushtimit të arrijë në tetë. Në mesin e tyre bën pjesë edhe Putini, i cili dyshohet për krime lufte, përkatësisht për dënimin e fëmijëve ukrainas për në Rusi.

GjNP-ja nuk ka forcë të saj policore dhe varet nga shtetet anëtare që t'i kryejnë arrestimet.

Rusia bëri shumë shkelje të të drejtave të njeriut në Krime, thotë Gjykata Evropiane

STRASBURG, 25 QERSHOR - Rusia ka bërë shumë shkelje të të drejtave të njeriut në Gadishullin e Krimesë prej se e aneksoi atë në vitin 2014, tha të martën Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (ECHR).

Në vendimin e saj, gjykata tha se shkeljet përfshijnë trajtim çnjerëzor apo degradues, shkelje të së drejtës për të jetuar, shkelje të lirisë fetare dhe lirisë së shprehjes.

Rasti u ngrit në ECHR nga Ukraina, e cila e akuzoi Rusinë edhe për përndjekjen e ukrainasve për shkak të qëndrimeve të tyre politike apo veprimtarisë së tyre në favor të Kievit, të cilat ndodhën kryesisht në Krime, por edhe në pjesë të tjera të Ukrainës apo në

Rusi.

Rusia i ka mohuar në të kaluarën akuzat se ka shkelur të drejtat e njeriut dhe se ka shtypur kundërshtarët politikë në gadishullin e aneksuar. "Gjykata vendosi njëzëri... se Rusia duhet të ndërmarrë masa sa më parë për kthimin e sigurt të të burgosurve relevantë të transferuar nga Krimea në burgjet e territorit të Federatës Ruse", thuhet në vendim.

Gjykata në Strasburg ka thënë më parë se rasti nuk ka lidhje me atë se a ishte i ligjshëm apo jo aneksimi i Krimesë sipas ligjit ndërkombëtar, por e mori parasysh praninë e madhe të ushtrisë ruse në Krime në periudhën janar-mars 2014 pa pëlqimin paraprak të Ukrainës.



Apeli në Shqipëri mban në fuqi dënimin me dy vjet burgim për Belerin

TIRANË, 25 QERSHOR - Gjykata e Posaçme e Apelit në Shqipëri vendosi të martën ta mbajë në fuqi dënimin e Alfred Belerit, kryetarit të zgjedhur të bashkisë së Himarës, me dy vjet burgim për vjedhje votash, duke e rrëzuar ankesën e tij.

Në mars, Gjykata e Posaçme e dënoi Belerin me dy vjet burgim për akuzën e vjedhjes së votave në zgjedhjet lokale të 14 majit 2023.

Beleri dhe avokatët e tij mbrojtës i kanë cilësuar akuzat politike dhe të pabazuara, por Apeli vendosi ta mbajë në fuqi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për dënimin e tij me dy vjet burgim.

Seancën e së martës e ndoqi nga salla e gjyqit edhe ambasadorja greke në Tiranë,

Konstantina Kamitsi. Ajo tha për medie, pas seancës, se "bashkia e Himarës ende drejtohet nga persona që nuk janë zgjedhur nga votuesit".

Apeli e shqyrtoi kah mesi i qershorit ankesën e Belerit, por e shtyu marrjen e vendimit për 25 qershor.

Beleri fitoi ulëse në Parlamentin Evropian si përfaqësues i partisë udhëheqëse në Greqi, Demokracia e Re, në zgjedhjet e qershorit.

Zgjedhja e Belerit deputet i Parlamentit Evropian shkaktoi polemika si për legjitimitetin e tij, po ashtu edhe për ndikimin e rastit të tij në integrimin evropian të Shqipërisë.

Juristë dhe ekspertë të marrëdhënieve ndërkombëtare



thonë se rasti i tij ngre shqetësime kushtetuese dhe ligjore. Sipas tyre, ai mund të ndikojë edhe në përpjekjet e Shqipërisë për anëtarësim në

Bashkimin Evropian, por edhe në marrëdhëniet e saj me Greqinë.

Beleri, me shtetësi shqiptare dhe greke, ishte kandidat i

opozitës për kryetar të Bashkisë së Himarës - qytet i banuar dhe me popullsi greke në jug të Shqipërisë - në zgjedhjet e majit të vitit 2023.

Ai u arrestua pak ditë para zgjedhjeve për blerje votash.

Pavarësisht se ishte në paraburgim atëkohë, Beleri i fitoi zgjedhjet, por nuk u betua asnjëherë. Në mars të këtij viti u dënua me dy vjet burgim.

Rasti nxiti kritika të mëdha në Athinë, ku Ministria e Jashtme tha se "dënimi dyvjeçar është padyshim joproporcional me masën e veprës së supozuar".

Partia e kryeministrit grek Kyriakos Mitsotakis e emëroi pastaj kandidat për zgjedhjet për Parlamentin Evropian, të cilat u mbajtën nga data 6 deri më 9 qershor, ku ai u zgjodh.

PDK-ja: Qeveria Kurti po e shkatërron administratën publike

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Anëtari i kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Përparim Gruda, e ka akuzuar qeverinë Kurti për politizim dhe shkatërrim të administratës publike. Gruda në një konferencë për medie tha se nisma për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Zyrat e Publikë bie ndesh me Kushtetutën e Kosovës dhe Marrëveshjen e Stabilizimit Asocimit që Kosova e ka me BE-në. “Me këtë ligj shkelet Marrëveshja e Stabilizimit Asocimit për Kosovën, sepse neni 120 i saj kërkon bashkëpunim me Bashkimin Evropian në fushën e reformave në administratën publike. Vlen të theksohet që edhe Zyra e BE-së në Kosovë e ka kundërshtuar këtë ligj. Neni 19 i Kushtetutës përcakton qartë se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës. Prandaj, Ligji për Zyrat e Publikë nuk



mund të jetë në kundërshtim me MSA-në sepse kështu ai është në kundërshtim edhe me Kushtetutën”, ka theksuar Gruda. Ai ka thënë se shumë nga vërejtjet e gjykatës lidhur me këtë ligj nuk janë adresuar, edhe

pse qeveria ka qenë e obliguar të bëjë këtë si dhe nuk ka pasur konsultim publik për të. “Ushtruesit e detyrës kanë një mandat prej 12 muajsh me mundësinë e vazhdimit edhe për 12 muaj të tjerë. Neni 17, paragrafi 3, thotë: ‘Nëpunësit

civilë të emëruar në pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese para hyrjes në fuqi të ligjit bazik konsiderohen se fillojnë mandatin e parë me hyrjen në fuqi të këtij ligji’. Kjo është në tërësi në kundërshtim me aktgjykimin e Gjykatës

Kushtetuese. Neni 11, paragrafi 5, përcakton: ‘Nëse brenda afatit prej nëntë (9) muajsh nëpunësi civil nuk sistemohet apo refuzon sistemimin në ndonjë pozitë të lirë të shërbimit civil, nëpunësi lirohet nga shërbimi civil’. Ky është një mekanizëm për shantazh dhe largim nga puna i nëpunësve publikë”, ka shpjeguar Gruda.

Ai ka deklaruar se edhe plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për Këshillin Prokurorial është jokushtetues. “Kjo po bëhet me tendencë për ndikim politik mbi organin e akuzës, sepse përbërja e tij është në kundërshtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese si sa i përket përfshirjes së politikës në KPK ashtu edhe përfshirjes së një anëtari nga Avokati i Popullit”, është shprehur Gruda.

PDK-ja i ka bërë thirrje qeverisë t’i ndalë veprimet që bien ndesh me Kushtetutën, MSA-në dhe aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese, në të kundërtën do t’i dërgojë këto ligje në Kushtetuese.

BE - Ballkani, takim i ministrave të jashtëm për rritje të bashkëpunimit



PRISHTINË, 25 QERSHOR - Zyrat e lartë të Bashkimit Evropian thanë të hënën se blloku duhet ta vazhdojë punën për anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, një zotim i kahershëm, i cili ka fituar në peshë për shkak të agresionit rus në Ukrainë.

Këto komente u bënë në prag të një takimi të ministrave të jashtëm të Bashkimit Evropian me ministrat e Jashtëm të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor për rritjen e bashkëpunimit në

fushën e sigurisë dhe punëve të jashtme.

Shefi i diplomacisë italiane, Antonio Tajani, tha se Bashkimi Evropian duhet të ecë përpara me anëtarësimin e vendeve të Ballkanit në bllok. “Ne duhet të vazhdojmë drejt anëtarësimin të plotë përpara vitit 2030 për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe më pas duhet të punojmë me Ukrainën dhe Moldavinë”, tha ai duke nënvizuar se vendet e Ballkanit janë kandidatë prej shumë vitesh.

Ministri i Jashtëm i Austrisë, Alexander Schallenberg, tha se është e rëndësishme që Bashkimi Evropian të vazhdojë ta mbajë vullin për anëtarësimin e vendeve fqinje. “Ne e pranojmë se kemi palë të treta, qoftë Rusia, Kina apo të tjera, të cilat po ushtrojnë ndikimin e tyre. Ballkani dhe Evropa Lindore janë fqinjësia jonë e afërt. Të dyja rajonet janë rreth pesëqind kilometra larg Vjenës. Ne duhet të arrijmë t’i kundërvihemi kësaj unaze zjarri që na rrethon ne,

Bashkimin Evropian, me një unazë qëndrueshmërie dhe sigurie. Për mua, kjo është detyra më e madhe gjeostrategjike e Bashkimit Evropian”, tha ministri i Jashtëm austriak.

Ministrja e Jashtme e Kosovës, Donika Gërvalla, tha se integrimi i vendeve që mbështesin vlerat evropiane nuk është vetëm çështje politike. “Por, janë më shumë çështje sigurie në Evropë, në një kohë kur përballemi me agresionin rus kundër Ukrainës dhe një Bashkim Evropian më i

fortë është një përgjigje më e mirë ndaj sfidave të sotme dhe në të ardhmen”, tha ministrja Gërvalla.

Bashkimi Evropian kërkon nga vendet e Ballkanit Perëndimor që t’i tejkalojnë problemet mes tyre dhe të angazhohen për fqinjësi të mirë. Blloku ka kushtëzuar integrimet evropiane për Kosovën dhe Serbinë me zbatimin e marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve, për të cilën palët u pajtuan vitin e kaluar në Bruksel dhe në Ohër.

Osmani: Sllovenia, mbështetëse e fortë e Kosovës në rrugën euroatlantike

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka uruar homologen Natasha Pirc Musar dhe popullin sloven për Ditën

Shtetërore. Osmani tha se “Sllovenia ka pasur arritje të jashtëzakonshme”. Ajo shprehu falënderim për

shtetin sloven për mbështetjen dhënë Kosovës. “Sot ne bashkohemi me ju për të festuar arritjet tuaja të jashtëzakonshme ndër vite. Populli i Kosovës është

mirënjohës për aleancën tonë të gjatë dhe për mbështetjen e fortë dhe të vazhdueshme të Sllovenisë për të ardhmen tonë euroatlantike”, shkroi ajo në “X”.





Pas nëntë muajsh tensione, Kurti dhe Vuçiqi përballë njëri-tjetrit

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Për herë të parë pas më shumë se nëntë muajsh, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, do të takohen më 26 qershor në Bruksel për të zhvilluar, sipas Bashkimit Evropian, një raund të ri bisedimesh për normalizimin e marrëdhënieve.

Takimi i fundit mes tyre, më 14 shtator 2023, përfundoi pa ndonjë pajtim.

Ata diskutuan për zbatimin e Marrëveshjes për Normalizimin e Marrëdhënieve, të arritur në shkurt të atij viti, por nuk u pajtuan për mënyrën.

Dhjetë ditë më vonë, më 24 shtator, ndodhi sulmi në Banjskë - fshat në pjesën veriore të Kosovës. Grupe të armatosura serbësh sulmuan Policinë e Kosovës atje, duke vrarë rreshterin Afrim Bunjaku. Në përlëshjen e armatosur që pasoi, u vranë edhe tre sulmues serbë.

Kosova fajësoi udhëheqjen shtetërore të Serbisë për sulmin, por ajo e mohoi çdo përgjegjësi.

Kurti tha, atëkohë, se dialogu për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë nuk mund të vazhdojë sikur nuk ka ndodhur asgjë në Banjskë.

Duke folur për gazetën britanike "Financial Times", ai tha se "nëse nuk do të ketë dënime dhe sanksione ndaj Serbisë pas asaj që ka bërë, definitivisht nuk do të ketë dialog". Por, ndërkohë, thirrjet e

bashkësisë ndërkombëtare për shtensionimin e situatës si dhe normalizimin urgjent të marrëdhënieve u shtuan. Diplomati perëndimorë zhvilluan vizita të njëpasnjëshme në Kosovë dhe në Serbi, në përpjekje për t'i kthyer palët në tryezën e negociatave.

Në fund të tetorit ata u paraqitën udhëheqësve të të dyja vendeve edhe një draft-statut për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, që do të duhej të formohej në Kosovë, por ai nuk u çua përpara.

Po atë muaj Kurti dhe Vuçiqi ishin në Bruksel dhe në margjina të një samiti të BE-së takuan veç e veç presidentin e Francës, Emmanuel Macron, kryeministren e Italisë, Giorgia Meloni, kancelarin e Gjermanisë, Olaf Scholz, dhe shefin e politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Josep Borrell. BE-ja i cilësoi ato takime si "mbështetje" për dialogun, por maratona e tyre përfundoi pa ndonjë përparim.

Duke ofruar një sinjal normalizimi, në dhjetor të atij viti Qeveria e Serbisë vendosi t'i lejonte makinat me targa të Republikës së Kosovës - RKS - të qarkullonin në territorin e saj. Paraprakisht në Kosovë makinat me targa ilegale serbe u reregjistruan me targa të Kosovës. Kosova, po ashtu, lejoi qarkullimin e lirë të makinave me targa të Serbisë, që u mirëprit nga

Bashkimi Evropian.

Por, në ditët e para të këtij viti, tensionet u rritën sërish, kur Banka Qendrore e Kosovës njoftoi, më 17 janar, se nga 1 shkurti valutë e vetme për pagesat me para të gatshme në Kosovë do të jetë euroja, duke ndaluar në këtë mënyrë dinarin serb.

Atëkohë autoritetet e Kosovës mbyllën, po ashtu, disa komuna paralele serbe në vend.

Kryenegociatorët e dy vendeve, Besnik Bislimi dhe Petar Petković, zhvilluan së paku shtatë takime për çështjen e dinarit - valutë në të cilën komuniteti serb, prej vitesh, pranoi të ardhura nga Serbia, por të gjitha të pasuksesshme.

Për këtë çështje Kurti dhe Vuçiqi u përballën në një takim të jashtëzakonshëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Situata vazhdoi të mbetet e tensionuar edhe në muajt e pranverës, kur komuniteti serb në veri të Kosovës i bojkotoi votimet për shkarkimin e kryetarëve shqiptarë të komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

Marrja e pushtetit prej tyre, në pranverë të vitit 2023, i çoi tensionet në kulm dhe Qeveria e Kosovës, nën tryshinë e bashkësisë ndërkombëtare, nxori një udhëzim administrativ, në bazë të të cilit do të zëvendësoheshin ata kryetarë.

Por, pas thirrjes së partisë kryesore serbe në Kosovë, Lista Serbe,

qytetarët serbë i bojkotuan votimet që do të çonin në zgjedhje të reja.

Serbët në veri i rezistuan edhe regjistrimit të popullsisë, të organizuar nga institucionet e Kosovës, ndërkohë që Serbia u angazhua në fushatë për ta penguar anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës.

Kosova nuk u fut në agjendën e kësaj organizate në maj, kur do të vendosej për anëtarësimin e saj, pasi refuzoi të merrte hapa në drejtim të formimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, ashtu siç i kërkuan diplomatët perëndimorë.

Ndërkohë që pritet takimi i radhës Kurti - Vuçiq, një tjetër çështje që e mban në tërësi situatën, është ura kryesore mbi lumin Ibër në Mitrovicë, e cila ndan këtë qytet në jugun me shqiptarë dhe verin me serbë.

Duke qenë prej vitesh vend i tensioneve, hapja e saj për qarkullim u aktualizua në javët e fundit nga Kuvendi Komunal i Mitrovicës së Veriut, por rriti shqetësimet e komunitetit ndërkombëtar për sigurinë.

Qeveria e Kosovës i tha Radios Evropa e Lirë se në fokus të takimit të 26 qershorit në Bruksel "do të jetë zbatimi i Marrëveshjes drejt normalizimit të raporteve, Aneksi për zbatimin e saj dhe rruga përpara".

Nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, Kosova dhe Serbia janë

në negociata për normalizimin e marrëdhënieve që nga viti 2011, por shumë nga dhjetëra marrëveshjet e arritura mbeten pa u zbatuar.

Kosova e konsideron Serbinë kërcënim për sigurinë e saj, Serbia e sheh si të tillë Qeverinë e Kosovës për serbët në Kosovë.

BE-ja ua ka kushtëzuar të dyja vendeve përparimin drejt anëtarësimin në këtë bllok me normalizimin e marrëdhënieve.

Ndaj Kosovës, BE-ja mban në fuqi edhe disa masa ndëshkuese, të cilat u ndërmorën pas përshkallëzimit të tensioneve në veri në vitin 2023, por në javën e kaluar paralajmëroi se ato do të hiqen "pjesërisht dhe gradualisht". Në gati tre vitet e kaluara Kurti dhe Vuçiqi zhvilluan gjithsej tetë takime, por të gjitha përfunduan pa ndonjë marrëveshje të nënshkruar.

Sytë e opinionit në të dyja vendet do të jenë të mërkurën në Bruksel për të parë se si do të përfundojë i nënti. Ai vjen pas vizitave që i dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak, zhvilloi javën e kaluar në Prishtinë e në Beograd.

A ka diçka që ndodhi në prapaskenë në lidhje me sulmin në Banjskë, që i parapriu këtij takim? Nuk dihet. Ish-nënkryetari i Listës Serbe, Millan Radoičiq, që e mori përgjegjësinë për sulmin, mbetet ende i lirë dhe sanksione kundër Serbisë nuk u ndërmorën.

Stano: Kosova ende nuk e ka dorëzuar raport për sulmin në Banjskë

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Zëdhënësi i Bashkimit Evropian, Peter Stano, në një konferencë për medie, edhe njëherë i është rikthyer sulmit terrorist në Banjskë që ndodhi më 24 shtator të vitit të kaluar, ku u vra polici i Kosovës Afrim Bunjaku.

Stano ka theksuar se "autoritetet e Kosovës ende nuk kanë dorëzuar raport lidhur me hetimet në Banjskë". "Në lidhje me hetimin. Fillimisht, hetimi

duhet të bëhet nga autoritetet e Kosovës. Nëse po i referoheni incidentit në Banjskë, të 24 shtatorit, kjo është diçka që ka ndodhur në territorin e Kosovës dhe autoritetet e Kosovës janë përgjegjëse për hetimin dhe ofrimin e një raporti të plotë hetimi. Kjo nuk ka ndodhur ende, kështu që nuk mund të vazhdojmë pa pasur rezultatet e hetimit", ka thënë Stano, duke shtuar se menjëherë pas sulmit, ditë, javë e muaj më vonë,

kanë bërë të qartë pozitën e BE-së se çka presin nga dy palët, nga Kosova dhe Serbia, kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen e mundshme ose mbështetjen e këtij sulmi të tmerrshëm nga ana serbe. "E gjithë kjo duhet të jetë objekt hetimi. Gjetjet do të përfshihen në raportin final, i cili, me gjasë, nuk është përfunduar ende ose, të paktën, nuk na është vënë në dispozicion deri në këtë fazë", ka deklaruar Stano.



Berisha, ftesë demokratëve: Kthehuni në shtëpinë tuaja, duhet një front i gjerë opozitar



TIRANË, 25 QERSHOR - Kreu demokrat Sali Berisha u shpreh se duhet të bëhet gjithçka për t'i mirëpritur në shtëpinë e tyre të gjithë ato demokrate dhe demokratë që e ndiejnë veten të tillë dhe duan të bashkohen me PD-në.

Me një mesazh në mbledhjen e Kryesisë së PD-së, e cila është zhvilluar në selinë e kësaj

partie, Berisha tha se "asnjë nga ne nuk duhet të shikojë vëngër apo me skepticizëm ata që duan të bashkohen me ne". "Armiku ynë i përbashkët është Edi Rama. PD-ja ka nevojë jo vetëm të bashkohet me të gjithë anëtarët dhe mbështetësit e saj, por ka nevojë të bashkohet me shumë se kurrë me të gjithë spektrin

opozitar", tha Berisha.

Ai u shpreh se një front i gjerë dhe i bashkuar opozitar është i një rëndësie vendimtare.

Berisha tha se Edi Rama është në pushtet, dhunon çdo ligj e Kushtetutë të këtij vendi, edhe për faktin se ne e lejojmë atë. Sipas tij, regjimi i Edi Ramës duhet luftuar nga të gjithë shqiptarët, duke shtuar se të tre

drejtuesit e partive opozitare janë në hetim nga SPAK.

Ai tha se skandalet e kësaj qeverie nuk kanë të ndalur, ndërsa shtroi pyetjen: ku jemi ne, cila është detyra jonë? "Detyra jonë është një dhe vetëm një, krijimi i qeverisë teknike dhe shpëtimi i vendit nga ky regjim", tha Berisha. Sipas tij, qeveria teknike

krijohet në mënyrën më të pashmangshme se Edi Rama nuk ka më legjitimitet, ai dëshmoi në zgjedhjet e 14 majit se është i gatshëm të shkelë çdo ligj, normë, moral dhe Kushtetutë. "Ai qëndron në pushtet për shkak të dobësisë së opozitës, ndaj ne duhet t'ua bëjmë të qartë mbështetëseve tanë", tha Berisha.

Szunyog takon Lladrovcin, e përgëzon për zbatimin e projektit të BE-së për arsim

DRENAS, 25 QERSHOR - Shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, ka njoftuar se të martën ka vizituar Drenasin dhe

është takuar me kryetarin Ramiz Lladrovci. Në platformën "X" ai ka theksuar se kanë diskutuar për çështjet e

qeverisjes lokale. "E përgëzoja për zbatimin e një projekti të financuar nga BE-ja që synon adresimin e nevojave të

sistemit arsimor të Kosovës dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies", ka thënë Szunyog.



Gjykata ua vazhdon paraburgimin tre të dyshuarve për vrasjen e Liridona Murselit

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Gjykata Themelore në Prishtinë ka marrë vendim me të cilin ua ka vazhduar edhe për nga dy muaj të tjerë masën e paraburgimit Naim Murselit, Kushtrim Kokallës dhe Granit Plavës, të cilët dyshohen për vrasjen e Liridona Ademajt. Lajmin për "Betimi për Drejtësi" e ka konfirmuar bashkëpunëtorja profesionale nga zyra e kryetares së kësaj gjykate, Medina Gashi. "Ju informoj se të pandehurve N. M., G. P. dhe K. K. u është vazhduar masa e paraburgimit për dy muaj me Aktvendimin e datës 21.06.2024, e cila masë do t'u llogaritet nga data 27.06.2024 deri më 26.08.2024, në kushtet ligjore të parapara në KPPK", thuhet në përgjigjen e Gashit. Fillimisht tre të dyshuarve Gjykata Themelore në Prishtinë më 3 dhjetor 2023 ua kishte caktuar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 ditësh, të cilin

vendim e kishte lënë në fuqi edhe Gjykata e Apelit.

Të dyshuarit të katërt në këtë rast, T. D., më 11 dhjetor 2023 i është caktuar masa e paraburgimit. Ai është arrestuar më 9 dhjetor, i dyshuar se ia ka shitur armën dorasit.

Për të dyshuarin e katërt, T. D., Gjykata Supreme kishte marrë vendim t'i ndërpritet masa e paraburgimit dhe të mbrohet në liri pasi ai kishte paraqitur ankesë kundër vendimeve të dy gjykatave më të ulëta të cilat e linin në paraburgim.

Ende nuk dihen motivet se pse ka ndodhur vrasja e Ademajt, e cila kishte nënshtetësi suedeze bashkë me burrin e saj dhe dy djemtë.

Në këtë rast të dyshuar për vrasjen e Ademajt janë bashkëshorti i saj Naim Murseli si i dyshuar se organizoi vrasjen, Granit Plava, Kushtrim Kokalla, si dhe T. D.



Kamberi: Nuk ka gatishmëri që sanksionet ndaj Kosovës të hiqen komplet

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Sa i përket takimit të paralajmëruar në mes të kryeministrit Albin Kurti dhe presidentit serb Aleksandër Vučić që do të mbahet të mërkurën në Bruksel, analisti Belgzim Kamberi thotë se ky takim po bëhet vetëm që të bëhet me dije se "dialogu është ende këtu". Ai shton se takimi i bërë në mes të Vučićit dhe presidentit francez Emanuel Macron shpreh një lloj gatishmërie të Parisit që ta rritë presionin ndaj Republikës së Kosovës për çështjen e Asociacionit. "Mendoj që ky

takim më shumë është i thirrur për të treguar që dialogu nuk ka vdekur politikisht, por që s'ka vdekur as plani franko-gjerman, plani i BE-së. mendoj se kjo është më shumë një përpjekje e Bashkimit Evropian, e ndërmjetësuesve, nga ana tjetër kanë ndodhur disa fenomene. E kemi parë një takim të Vučićit me Macronin, ku duket se ka njëfarë lloj gatishmërie të Parisit zyrtar për ta rritur presionin ndaj Kosovës për çështjen ndaj Asociacionit", ka thënë Kamberi në "Debat Plus".

E sa iu përket sanksioneve, Kamberi thotë se nuk ka gatishmëri që ato të hiqen komplet ndaj Kosovës. "Ka mundësi që Franca me disa vende të tjera, veçanërisht Italia, që duket se po llobojnë për të mos ia hequr Kosovës sanksionet komplet, por në mënyrë graduale. Nuk duket se ka gatishmëri për t'i larguar komplet sanksionet, dhe sanksionet ka prirje të ndërlihen me çështjen e Asociacionit, me dërgimin e draft-statutit evropian në Gjykatë Kushtetuese", ka thënë Kamberi.



Procedohen për në seancë projekt-rezoluta e raportit të punës së AIP-së dhe raporti i KSK-së



PRISHTINË, 25 QERSHOR - Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, me të gjitha votat për, ka miratuar projekt-rezolutën lidhur me Raportin e Punës së Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2022 si dhe ka votuar raportin me rekomandime për Projektligjin për Këshillin e Sigurisë së Kosovës, të cilat janë proceduar për seancën plenare të Kuvendit të Kosovës, raporton Ekonomia Online.

Sa i përket raportit të Punës së Agjencisë për Informim dhe Privatësi, kryetari i Komisionit, Bekë Berisha, ka thënë se ky

raport, pas votimit, dërgohet në seancë për shqyrtim. "Si Komision e kemi shqyrtuar si raport, por për procedim janë pritur edhe rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Tani janë plotësuar kushtet për votim. Nëse jeni dakord votojmë për dërgimin e tij në seancë plenare", ka thënë ai.

Ndërsa sa i përket Projektligjit për Këshillin e Sigurisë së Kosovës, deputeti i PDK-së, Rashit Qalaj, ka propozuar që amendamentet e propozuara nga ai të largohen

nga ky projektligj. E deputeti i LDK-së, Anton Quni, shprehu shqetësim për kushtet e punës që ka personeli i Këshilli të Sigurisë së Kosovës, për të cilët tha se kjo çështje duhet të ngrihet në institucionet qeveritare për t'u siguruar ambient të duhur të punës këtyre zyrtarëve. Me konstatimin e deputetit Quni u pajtua edhe kryetari i Komisionit, Bekë Berisha, i cili tha se kjo çështje duhet të trajtohet. Në fund, me të gjitha votat për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, anëtarët e Komisionit e votuan këtë projektligj.

Policia, mesazh bashkatdhetarëve: Respektojini rregullat e trafikut rrugor!

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Policia e Kosovës u ka uruar mirëseardhje bashkatdhetarëve

në vendlindje. Gjithashtu, u ka kërkuar t'i respektojnë rregullat në trafikun rrugor, në mënyrë

që të ketë siguri. Në shkrimin e policisë në "Facebook" janë publikuar edhe gjodat që

parashihen në rastet kur shkelen rregullat e trafikut.



Trafikimi i qenieve njerëzore, DASH-i jep rekomandime për Kosovën dhe Shqipërinë



PRISHTINË, 25 QERSHOR - Departamenti Amerikan i Shtetit publikoi raportin vjetor mbi trafikimin e qenieve njerëzore në mbarë botën. Gjatë publikimit të tij, sekretari i Shtetit, Anthony Blinken, tha se dokumenti ofron vlerësimin më gjithëpërfshirës rreth fenomenit si dhe përpjekjeve të qeverive për ta luftuar atë.

Ai shtoi se duke matur përparimin e shënuar në 188 vende, përfshirë Shtetet e Bashkuara - Uashingtoni synon zbatimin e angazhimit të presidentit Biden për ta parandaluar trafikimin, për t'i ndjekur penalisht autorët e këtij krimi si dhe mbrojtjen e viktimave të tij.

Sekretari Blinken tha se rreth 27 milionë individë në të gjithë botën janë të shfrytëzuar për punë, shërbime dhe seks komercial. Nëpërmjet forcës, mashtrimit dhe detyrimit, ata

detyrohen të punojnë në fusha dhe fabrika, në restorante dhe banesa. Viktima janë individët më të pambrojtur në botë - duke përfutur nga gjendja e tyre e vështirë.

Raporti i ndan vendet në tri nivele. Në nivelin e parë përfshihen vendet - qeveritë e të cilave respektojnë plotësisht standardet minimale.

Në nivelin e dytë hyjnë ato vende përpjekjet e të cilave nuk plotësojnë tërësisht standardet minimale, por që qeveritë bëjnë përpjekje të konsiderueshme për ta arritur një gjë të tillë.

Në nivelin e tretë futen vendet, përpjekjet e të cilave nuk plotësojnë tërësisht standardet minimale dhe që qeveritë nuk bëjnë përpjekje në këtë drejtim. Si Shqipëria ashtu edhe Kosova renditen këtë vit, ashtu si edhe vitin e kaluar, në kategorinë e vendeve të nivelit të dytë.

Situata në Shqipëri

Në raport thuhet se qeveria ka dëshmuar përpjekje të përgjithshme në rritje krahasuar me një vit më parë. Përpjekjet përfshinin hetimin e trafikantëve të seksit, identifikimin e një numri më të madh viktimash të mundshme në bashkëpunim me organizatat joqeveritare si dhe ofrimin e shërbimeve për më shumë viktime.

Por në raport shtohet se qeveria nuk i përmbushi standardet minimale në disa fusha kyçe. "Qeveria hetoi në mënyrë të qartë më pak krime që lidhen me trafikimin, ndoqi penalisht më pak të dyshuar si dhe nuk dënoi asnjë trafikant për të dytin vit me radhë", thuhet në raport.

Po kështu konstatohet se policia dhe prokurorët e rretheve nuk kanë përvojën dhe specializimin e

duhur për t'i hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e trafikimit dhe se autorët e dyshuar janë dënuar për krime më të vogla, si "shfrytëzim prostitucioni", në vend të trafikimit.

Në raport thuhet se qeveria nuk ka kontrolluar vazhdimisht atë pjesë të komunitetit që potencialisht mund të jetë viktimë e trafikut si emigrantët, azilkërkuesit, komunitetet rom dhe egjiptian, si dhe fëmijët.

Kosova

Në raport thuhet se qeveria demonstroi përpjekje të përgjithshme në rritje krahasuar me periudhën e mëparshme. Ato përfshinin dënimin e të gjithë trafikantëve me burgim, aty ku ishte e përshtatshme dhe mosshqiptimin e ndonjë dënimi vetëm me gjobë.

Në raport thuhet se qeveria rriti përpjekjet e përgjithshme

parandaluese, përfshirë shtimin e fondeve për fushatat ndërgjegjësuese dhe shpërndarjen e manualeve për parandalimin e trafikimit të fëmijëve.

Por në raport konstatohet se, megjithatë, qeveria nuk i përmbushi standardet minimale në disa fusha kyçe. "Qeveria hetoi dhe ndoqi penalisht më pak të dyshuar dhe identifikoi më pak viktime. Edhe pse gjyqtarët dhanë dënime më të forta, dënimet, megjithatë, ishin nën dënimin minimal të parashikuar nga ligji kundër trafikimit", vijon më tej raporti.

Në raport konstatohet me shqetësim edhe fakti se kodi penal i Kosovës e klasifikon lypjen e detyruar të fëmijëve nga prindërit e tyre si neglizhencë, ose abuzim prindëror dhe jo trafikim, duke e vështirësuar identifikimin e kësaj veprë si dhe referimin e viktimave potenciale të shërbimit e duhura.

Rekomandime

Raporti rekomandon hetimin dhe ndjekjen me forcë të krimeve të trafikimit si dhe dhënien e masave të duhura të dënimit për trafikantët, duke përfshirë zyrtarët që bashkëpunojnë me ta.

Po kështu kërkohet identifikimi në mënyrë proaktive i viktimave të trafikimit duke kontrolluar treguesit e trafikimit në mes të popullatës së ndjeshme, përfshirë individët e përfshirë në seks komercial; fëmijë; komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian.

Në raport sugjerohet ofrimi i trajnimeve të avancuara për gjyqtarët, prokurorët dhe forcat e rendit mbi hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të trafikimit.

Po kështu kërkohet forcimi i masave të ruajtjes së privatësisë së viktimës e që informacionet e tyre të mos shpërndahen.

Më tej në raport sugjerohet rritje e mbështetjes së qeverisë për shërbimet gjithëpërfshirëse të trajnimit profesional si dhe riintegrimin të viktimave.

Delegacioni i Kosovës për vizitë në KiE, Bogujevci: Rrugëtimi i Kosovës drejt anëtarësimit, rrugë njëkahëshe

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Delegacioni i Kosovës, i udhëhequr nga nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës, Saranda Bogujevci dhe anëtarët Arben Gashi, Enis Kervan, Ariana Musliu-Shoshi dhe Besnik Tahiri, ka takuar presidentin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Theodoros Rousopoulos.

Gjatë takimit, nënkryetarja Bogujevci e falënderoi presidentin Theodoros

Rousopoulos për liderhipin dhe angazhimin e tij shumë efektiv dhe për votën dhe mbështetjen e madhe që iu dha Kosovës në votimin në Asambleen Parlamentare.

Nënkryetarja Bogujevci theksoi se tanimë rrugëtimi i Kosovës drejt anëtarësimit është rrugë njëkahëshe dhe se ka mbetur vetëm edhe një hap për t'u përmbyllur një mision, që është fisnik e i drejtë për qytetarët e Kosovës.

Më tutje, ajo tha se bashkëpunimi i Republikës së Kosovës me këtë institucion do të vazhdojë të thellohet, në veçanti do të shtohet pas anëtarësimit që pritet të ndodhë me një vendim të drejtë të Komitetit të Ministrave.

Delegacioni gjatë këtij sesi do të zhvillojë takime edhe me personalitete dhe anëtarë të delegacioneve të tjera pjesëmarrëse si dhe takime me krerët e grupeve politike.



Mbyllen mbi 30 qendra masazhi dhe lokale me muzikë nate

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut ka njoftuar se ka mbyllur mbi 30 qendra masazhi dhe lokale me muzikë nate. "Gjatë datave 3-8 qershor 2024 Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut, në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ka realizuar një aksion të gjerë inspektimi tek operatorët ekonomikë të cilët ushtrojnë veprimtari tregtare - aktivitete të mirëmbajtjes trupore (qendra masazhi) dhe aktivitete të tjera të argëtimit dhe rekreacionit (muzikë

nate)", është bërë me dije në njoftimin për medie, duke theksuar se aksioni u zhvillua nga Inspektorati i Tregut pranë Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, përkatësisht Drejtorinë për Hetimin e Trafikimit të Njerëzve si dhe në bashkëpunim me inspektorë të Administratës Tatimore të Kosovës dhe Inspektoratin Qendror të Punës, me ç'rast janë mbyllur mbi 30 operatorë ekonomikë nga rreth 90 prej tyre sa janë inspektuar. "Aksioni i përbashkët ka rezultuar me mbyllje të



përkohshme të mbi 30 operatorëve ekonomikë në tërë territorin e Republikës së

Kosovës për shkak të mosregjistrimit të bizneseve si dhe mungesës së

pëlqimit/aktvendimit për plotësimin e kushteve minimale teknike. Ndaj operatorëve ekonomikë që ushtronin veprimtarinë e tyre në kundërshtim me ligjin janë shqiptuar afër 50 masa ndëshkuese sipas legjislacionit në fuqi. Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut konform kompetencave ligjore që ka do t'i vazhdojë inspektimet edhe në ditët në vijim dhe nëse konstatohen shkelje do të ndërmerren masa për ndalim të ushtrimit të veprimtarisë si dhe masa të tjera ndëshkuese sipas legjislacionit aktual në fuqi", është thënë në njoftim.

AKP-ja ofron për shitje 47 lokale dhe prona atraktive në disa rajone të Kosovës

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Agjencia Kosovare e Privatizimit ka ftuar të interesuarit që të konkurrojnë për t'u bërë pronar të 47 pronave në lokacione atraktive në disa qytete të Kosovës përmes tenderit që është shpallur më 6 qershor dhe do të mbyllet më 26 qershor.

Vala e shitjes së aseteve me nr. 66 (ShAL 66) përfshin 13 asete në rajonin e Prishtinës, ku ka ndërtesa administrative, lokale, depo e toka, që paraqesin mundësi të shkëlqyer për zhvillimin e veprimtarive biznesore. Në rajonin e Prishtinës, po ashtu, ka lokale e toka në shitje edhe në komunën e Podujevës dhe të Graçanicës.

Në rajonin e Pejës janë në shitje 10 asete, si ndërtesa e lokale, depo si



dhe objekt hotelier (motel), që gjenden në Pejë, Gjakovë, Klinë e Istog. Gjithashtu në rajonin e Pejës janë vendosur për shitje edhe toka bujqësore që janë të përshtatshme për kultivimin e kulturave të

ndryshme bujqësore dhe për zhvillimin e biznesit. Në rajonin e Prizrenit mund të ofertoni për blerje të lokaleve dhe depove. Janë gjithsej 10 lokale në shitje në këtë rajon. Për më tepër

në këtë rajon në tender ka prona që gjenden edhe në komunën e Dragashit.

Në rajonin e Mitrovicës AKP ka nxjerrë në shitje 12 asete, lokale, zyra me sipërfaqe të ndryshme atraktive për zhvillim biznesi. Po ashtu, ka asete edhe në komunën e Mitrovicës e të Vushtrrisë. Të gjitha këto asete të ndërmarrjeve shoqërore paraqesin mundësi të shkëlqyer për zgjerim të biznesit apo iniciativa të reja biznesore në vendin tonë, kurse në rajonin e Gjilanit janë 2 asete të tenderuara në ShAL 66.

Blerësit mund të konkurrojnë për njërin nga këto asete apo mund të konkurrojnë për më shumë asete. Gjithë procesi i dorëzimit të ofertave dhe i hapjes dhe zbulimit

të çmimeve është i siguarur dhe garantuar dhe zhvillohet me transparencë të lartë, në prani të medieve dhe gjithë blerësve konkurrentë dhe transmetohet drejtpërdrejt.

Ofertat e mbyllura për njësitë/asetet që janë në shitje përmes Shitjes së Aseteve me Likuidim nr. 64 duhet të dorëzohen në "Sallën e konferencave - Hoteli Grand", në Prishtinë, më 26.06.2024, nga ora 10:00 deri në orën 12:00, të shoqëruara edhe nga depozita e ofertës dhe tarifa për paraqitjen e ofertës, ashtu siç është parashikuar për secilin artikull, kurse hapja e ofertave do të bëhet po të njëjtën ditë, duke filluar nga ora 12:30.

BQK-ja publikon statistikat e muajit maj: 232.94 milionë euro kredi të reja

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka publikuar statistikat e bankave komerciale për muajin maj. Asetet e bankave komerciale në fund të muajit maj 2024 kanë arritur vlerën në 7.40 miliardë euro, duke shënuar rritje për 0.25 % krahasuar me muajin paraprak, kryesisht për shkak të rritjes së kredive bruto, të cilat në fund të muajit maj kanë arritur vlerën në 5.22 miliardë euro. Krahasuar me muajin paraprak kreditë bruto në maj 2024 janë rritur për 80.99 milionë euro ose 1.58 %.

Vlera e kredive të reja në muajin

maj 2024 ishte 232.94 milionë euro. Norma mesatare e interesit në kredi në muajin maj 2024 ishte 6.14 % (në prill 2024 ka qenë 6.07 %). Depozitat e klientëve në maj 2024 kanë arritur vlerën prej 6.07 miliardë eurosh, duke shënuar rritje për 34.78 milionë euro, ose 0.58 % krahasuar me muajin paraprak.

Nga vlera e akumuluar e depozitave të klientëve, rreth 27.05 % janë të afatizuara. Sipas sektorëve, ekonomitë familjare dominojnë me rreth 67.65 % të gjithë vlerës së depozitave.

Vlera e depozitave të reja në



muajin maj 2024 ishte 56.24 milionë euro.

Norma mesatare e interesit në depozita në muajin maj 2024

ishte 2.48 % (në prill 2024 ka qenë 2.55 %).

Margjina e normës së interesit në kredi dhe depozita në muajin maj 2024 ishte 3.65 % (në prill 2024 ka qenë 3.53 %).

Raporti kredi-depozita në muajin maj 2024 ishte në nivelin 86.08 %.

Gjithësej kapitali i bankave komerciale në fund të muajit maj 2024 arriti vlerën në 890.34 milionë euro, ndërsa provizionet për kredi u rritën për 0.91 milion euro apo 0.61 % krahasuar me muajin paraprak, duke arritur vlerën 148.66 milionë euro.

KEDS-i thotë se po shënon rezultate të mëdha ndaj vjedhjeve të energjisë elektrike



PRISHTINË, 25 QERSHOR - "Si rezultat i luftës së pakompromis ndaj keqpërdorimeve, humbjet e energjisë elektrike në pesëmujorin e parë të vitit 2024 janë 25.75 % më të vogla

se në periudhën e njëjtë të vitit 2021", ka njoftuar KEDS. Më tej thuhet se "gëzon fakti që rënia është konstante nga viti në vit. Tashmë ato kanë rënë 15 % në total të energjisë elektrike nga 20.23

% sa ishin para tre vjetësh. Kompania nuk do të ndalet me kaq, pasi ka synim ta zhdukë komplet fenomenin e vjedhjeve të energjisë elektrike në Kosovë", ka njoftuar KEDS-i.

Babai i Anne Frankut dhe jeta pas vdekjes së saj



Nga: Myles BURKE / BBC
Përkthimi: Telegrafi.com

Në fillim, Otto Frank nuk mund të përballonte leximin, e lëre më të publikonte ditarin e vajzës së vet i cili u publikua 77 vjet më parë në këtë javë. Në vitin 1976, shkoi në programin e BBC-së, Blue Peter, për të shpjeguar se pse këtë e bëri. “Mësova ta njoh tamam vetëm përmes ditarit të saj”, i rrëfeu Otto Frank gazetares Lesley Judd, teksa ia tregonte shkrimet personale të vajzës së ndjerë e të dashur Anne. Më 12 qershor 1942, Otto ia kishte dhënë vajzës së vet të zgjuar një libër të autografeve – si dhuratë për ditëlindjen e saj të trembëdhjetë. Por, Anne pothuajse menjëherë vendosi ta përdorte si ditar dhe nisi t’i shënojë mendimet më të thella, duke shkruar thuajse po zbulonte sekretet e një shoqe e ngushtë. “Shpresoj se do të jem në gjendje të të besoj, tërësisht, siç nuk kam qenë në gjendje t’i besoj askujt tjetër më parë”, lexoi Otto nga ditari i parë i Annes, në programin televiziv për fëmijë. “Dhe, shpresoj se do të jesh mbështetje dhe ngushëllim i madh për mua”.

Pas suksesit të nazistëve në zgjedhjet federale gjermane dhe kur Adolf Hitlerit u emërua kancelar i Rajhut, me familjen e vet Otto largohet nga Frankfurti – ku Anne kishte lindur – për të shkruar në Amsterdam më 1933. Por, siguria të cilën e ofronte kryeqyteti holandez, ndaj kërcënimit të nazistëve, do të ishte vetëm një pushim i përkohshëm për familjen. Në vitin 1940, pasi kishte

marrë pushtetin dhe shpallur veten Firer, Hitleri pushtoi Holandën. Me pushtimin gjerman erdhi një valë e masave antisemite. Hebrejve iu ndalua të kenë biznese, u detyruan të mbanin yje të verdhë identifikues dhe u përballën me shtettrëhim.

Otto, si shumë hebrej të tjerë ishte përpjekur – që nga viti 1938 – që të emigronte në ShBA, por mungesa e një politike azili dhe procesi i gjatë për të marrë vizën, bënë që dokumentet të mos përfundonin para se nazistët të mbyllnin zyrat konsullore të ShBA-së, në korrik 1941, në të gjitha territoret e pushtuara nga gjermanët.

Një muaj pas ditëlindjes së Annes më 1942, vajza më e madhe e Ottos, Margot, merr njoftimin për t’u paraqitur në një kamp pune në Gjermani. Për t’iu shmangur autoriteteve, e gjithë familja u zhvendos në një aneks sekret të cilin Otto e kishte zbuluar mbi ambientet e biznesit të tij në Amsterdam. Për dy vitet e ardhshme, familja Frank u fsheh në atë hapësirë, së bashku me një familje tjetër dhe një mik familjar. Të kufizuar në aneks, të gjithë që jetonin atje detyroheshin të rrinin të heshtur gjatë ditës dhe nuk mund të përdornin tualetin deri në natë kur zyra pastrohej – nga frika se mos dëgjohehin. Ushqimi dhe furnizimet u futën kontrabandë nga një grup i vogël i ndihmësve të besuar.

Gjatë gjithë kësaj kohe, Anne vazhdoi të shkruante fshehtas mendimet e veta në ditar. Për shkak të dëshirës së saj për miqtë e moshës, shpiku personazhe të

trilluara, si Kiti, të cilëve ajo u shkruante. Ankthi, aspiratat dhe mërzia e saj, së bashku me zhgënjimet e përditshme të jetesës në hapësirë të ngushtë me njerëzit e tjerë, që të gjitha paraqiteshin në faqet e ditarit të saj.

Pjesa e fundit është më 1 gusht 1944. Mëngjesin e 4 gushtit, Gestapoja u fut në strehë dhe të gjithë banorët u arrestuan. Arsyeja e zbulimit të tyre mbetet ende temë e diskutueshme.

Familja Frank u dërgua në kampin e përqendrimit Aushvic-Birkenau ku Otto u nda nga gruaja e Edith dhe nga vajzat Margot dhe Anne. Nuk do t’i shihte kurrë më. Të tri ato vdesin në kamp. Anne, e cila së bashku me të motrën u transferuan përfundimisht në kampin e përqendrimit Bergen-Belsen, vdiq nga tifoja në mars 1945 – vetëm disa javë para se kampi të çlirohej.

Otto ishte i vetmi anëtar i aneksit i cili mbijetoi. Pas luftës, u kthye në Amsterdam për të kërkuar familjen e vet, por u shkatërrua kur mori vesh për fatin e tyre. Ditari dhe letrat e Annes shpëtuan nga streha e plaçkitur – nga miqtë Miep Gies dhe Bep Voskuijl, të cilët ia dhanë ato pas kthimit. Por, në pikëllimin që kishte, nuk mundi t’i shikonte. “Nuk kam forcë t’i lexoj”, i shkruante nënës së vet në Zvicër, më 22 gusht 1945.

Kur Otto më në fund mundi të hapte ditarët, shkrimet ishin zbulim i ri për të. Ia ofruan atij dritaren për në mendjen e vajzës së zgjuar adoleshente, të pambrojtur dhe ekspresive, teksa lundronte në kompleksitetin e adoleshencës në rrethanat më të

tmerrshme. Me tone të pazbukuruara, detajohen përplasjet me nënën dhe pakënaqësitë ndaj motrës, shqetësimet për reputacionin dhe ndryshimin e trupit të saj. Gjithashtu, tregohet se sa shtypëse ishte mbyllja dhe heshtja e aneksit dhe se irritohej me njerëzit me të cilët jetonte. Shkroi për izolimin dhe kërcënimin e vazhdueshëm të tmerrshëm për zbulimin e tyre. Ndihej si “një zog këngëtar të cilit i janë prerë krahët dhe i cili në errësirë të plotë përplaset për grilat e kafazit”.

Por, Otto mëson edhe për momentet e saj të vogla të hareshme: natyrën të cilën e shikonte nga dritarja dhe romancën me Peter van Daanin, me djalin që gjithashtu jetonte në aneks.

Shkroi për ëndrrat e saj për patinazh në Zvicër dhe ambicjet për botim; mendimet e saj për identitetin dhe marrëdhëniet me miqtë janë reale dhe të imagjinuara.


Nisi të kuptonte mendjen komplekse dhe imagjinate të Annes teksa ndryshonte dhe piquej. “Nuk do të mund të shkruaja më një gjë të tillë”, shkroi për një nga shënimet e mëparshme në ditar. “Tani që rilexoj ditarin tim, pas një viti e gjysmë, jam e befasuar me pafajësinë time fëmijërore. Thellë në vete e di që nuk mund të jem më kurrë aq e pafajshme, sado që do të doja të isha”.

Mbi të gjitha, Otto e vlerësoi dhuntinë e Anës si shkrimtare dhe guximin dhe humanizmin e jashtëzakonshëm që kishte përballë terrorit të paepur të

rrethanave. “Pasi e lexova ditarin, e kopjova dhe një kopje ia dhashë miqve tanë që na njihnin që të gjithëve”, tha ai për Juddin e BBC-së më 1976. “Njëri prej tyre ishte i punësuar në një kompani botuese dhe tha se ‘ti nuk ke të drejtë ta mbash ditarin si pronë private; se është dokument njerëzor dhe se duhet ta publikosh’”.

Më 25 qershor 1947, u botua Aneksi sekret, libër i përpiluar nga shënimet dhe shkrimet e ditarit të Annes. Përveç korrigjimit të disa gabimeve gjuhësore, Otto e pastroi disa duke redaktuar disa përshtypje kritike të Annes për martesën e tij, pasazhet rreth seksualitetit të saj dhe ndonjëherë portretizimet e egra për njerëzit që njihje.

Libri doli të jetë sukses i menjëhershëm: një vajzë e vetme tregonte fytyrën e tmerrit dhe madhësinë pothuajse të pakuptueshme të gjenocidit nazist. Në vitin 1952 u botua në anglisht me titullin Ana Franku: Ditari i një vajze të re. U inskenua në shfaqjen që fitoi çmimin Pulitzer më 1956 dhe në film tre vjet më vonë. Fjalët e Annes e kanë tejkualuar jetën e saj të shkurtër; ato janë përkthyer në më shumë se 70 gjuhë dhe vazhdojnë të kenë jehonë te lexuesit në mbarë botën. I pyetur nga Judd, në Blue Peter, nëse kishte rezerva kur u pajtua për të publikuar dhe zbuluar mendimet më private të vajzës, Otto Frank tha: “Nuk u pendova, sepse Anna shkroi në një nga ditarët e saj, ‘Dua të vazhdoj të jetoj pas vdekjes’, dhe përmes ditarit të saj ajo në njëfarë mënyre po jeton në shumë zemra”. /Telegrafi/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Shqipëria krenohet me paraqitjet në 'Euro 2024'

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se kuqezinjtë largohen me kokën lart nga Kampionati Evropian "Euro 2024".

Kreu i qeverisë kujton rekordet kuqezi në këtë Evropian nga goli më i shpejtë në historinë e kompeticionit pas 23 sekondash në portën e Italisë tek ai më i voni në barazimin 2-2 ndaj Kroacisë. Rama pati fjalë të mira edhe për tifozët të cilët i pagëzoi si "dallga kuqezi" dhe lojtari i 12-të i Shqipërisë. "Nga goli më i shpejtë i evropianëve deri në sekondën e fundit të këtij Evropiani, Kombëtarja Kuqezi e kreu misionin e saj të pamundur duke luajtur futbollin më të mirë ndonjëherë në historinë e saj dhe me mbështetjen fantastike të dallgës kuqezi të lojtarit të 12-të. Sot skuadra jonë e re dhe me një potencial shumë premtues largohet nga ky Evropian me kokën lart, për t'u rikthyer në fushë më tej me një eksperiencë shumë të vyer, e cila i mungonte krejtësisht përballë tri nga fuqive më të mëdha të futbollit që u përballën me një Shqipëri të vogël, por me dinjitet të pamohueshëm nga askush", ka shkruar Rama.

I kënaqur me atë që treguan në Evropian është shprehur edhe trajneri Sylvinho, i cili ka thënë se të gjithë kanë pritur humbje të Shqipërisë me rezultat tri apo katër gola, por ndodhi e kundërta. "Jam krenar për lojtarët e mi, për vendin tim. Është hera e dytë që luajmë në këtë kompeticion. Jam i lumtur për vendin dhe federatën, për gjithë tifozët. Unë kam jetuar në Tiranë. Jam trajneri i parë që kam jetuar në Tiranë për 1 vit e gjysmë. Kam zbuluar lojtarë shumë të mirë. Njerëzit ndoshta mendonin se Italia mund të na kishte shënuar 3 gola, Kroacia 3 apo 4 gola dhe Spanja pesë gola. Ne, gjithsesi, kemi besuar te vetja jonë dhe te mundësitë tona. Jo vetëm që punuam mirë taktikisht, por edhe patëm besim. E dimë se do të na duheshin shumë sakrifica, për të provuar pastaj kundërsulmet, dhe natyrisht ia dolëm të konkurrojmë ndaj tri skuadrave të mëdha, ekupeve që zakonisht shkojnë në çerekfinale, gjysmëfinale apo finale të turneve të mëdhenj", ka thënë Sylvinho. Një prej lojtarëve që ka pasur paraqitje të shkëlqyeshme në këtë kompeticion ishte edhe mesfushori nga Kosova Ylber Ramadani. Ai ka thënë se është krenar se është shqiptar. "Krenar që jam shqiptar! I lumtur që isha pjesë

e Shqipërisë në këtë rugëtim në finale të 'Gjermani 2024'. Tri ndeshje, tri finale me tri nga ekipet më të mira të Evropës, dy prej të cilave janë shpallur edhe kampione Evropë dhe bote. Luajtëm fort, si të barabartë me Italinë, Kroacinë dhe Spanjën, duke treguar karakter në çdo sfidë. Faleminderit çunave, faleminderit stafit teknik dhe të gjithë stafit drejtues që ka qenë pranë nesh! Një falënderim të veçantë për tifozët që na kanë mbështetur në stadium, në çdo rrugë e shesh të Gjermanisë, si edhe çdo ditë në kampin tonë stërvitor. Mbi të gjitha, faleminderit Zotit! Përjetë: Forca Shqipëri!", ka deklaruar Ramadani. Paraqitje pozitive në Evropian për Shqipërinë e kanë konsideruar edhe mediet e ndryshme ndërkombëtare. Një nga këto medie, "Reuters", i ka kushtuar një analizë të veçantë kombëtares shqiptare dhe rugëtimit të saj në "Euro 2024", të cilin e konsideron si surprizën më të bukur, të paktën deri në këto momente të Evropianit që po zhvillohet në Gjermani. Shqipëria në ndeshjen e parë humbi ndaj Italisë me rezultat (2-1), më pas barazoi ndaj Kroacisë (2-2) dhe në ndeshjen e fundit pësoi humbje me rezultat minimal nga Spanja (0-1).

SHKURT

Halimi rikthehet te Sandhauseni

Mesfushori i Përfaqësueses së Kosovës në Futboll, Besar Halimi, do ta vazhdojë karrierën në futbollin gjerman te skuadra nga Bundesliga 3, SV Sandhausen. Halimi ka ndryshuar ambient, por jo edhe kampionat, pasi do ta vazhdojë karrierën në nivelin e tretë të futbollit gjerman. Ai e ka kompletuar kalimin nga Hallescher FC te SV Sandhausen, klub ku ka luajtur edhe në të kaluarën. Vetë faqja zyrtare e klubit gjerman ka njoftuar zyrtarisht për nënshkrimin me Halimin. "Kthimi perfekt: Besar Halimi vjen në Hardwood", shkruan shkurtimisht në postimin e SV Sandhausen. Me nënshkrimin është ndarë i lumtur edhe Halimi, i cili ka zhvilluar 32 ndeshje me fanellën e Kosovës. "Jam shumë i lumtur që jam rikthyer këtu në Hardtwald. Kam pasur shumë biseda pozitive me përgjegjësit dhe mezi pres të luaj përsëri për SVS", ka thënë Halimi pas nënshkrimit të kontratës.

Chelsea kërkon 35 milionë paundë për Brojën

Armando Broja ishte një prej yjeve që pritej shumë në "Euro 2024", por Shqipëria u eliminua që në fazën e grupeve dhe ai u aktivizua si titullar vetëm në ndeshjen e parë me Italinë. Menjëherë pas humbjes me Spanjën, Chelsea i ka vendosur Brojës çmimin 35 milionë paundë. Për gjigantin kuqez i interesohen klube jo vetëm nga Premierë Ligë, por edhe nga Bundesliga e Seria A. Evertoni dorëzoi një ofertë zyrtare prej 30 milionë paundësh pak ditë më parë dhe tashmë diferenca duket e vogël e për këtë arsye mund të themi se aventura e Brojës me "Blutë e Londrës" mund të ketë përfunduar.

Genc Hamiti, përforcimi i parë i Drenicës

Skuadra e Drenicës nga Skenderaj ka filluar të përforcohet për edicionin e ri futbollistik 2024/2025. Klubi kuqez është përforcuar me mesfushorin e njohur Genc Hamiti, i cili edhe në të kaluarën ishte pjesë e këtij klubi. "Me kënaqësi ju njoftojmë arrijtjen e marrëveshjes me mesfushorin Genc Hamiti, i cili rikthehet në 'follenë e vjetër' në kampin kuqez dhe zë në arenën drenicase. Destinacioni i tij është ekipi i vendlindjes së tij dhe Genci tashmë do të jetë një futbollist i ri i ekipit tonë për edicionin 2024/25. Pas bisedimeve mes drejtuesve të klubit dhe lojtarit është arritur akordi, dhe lojtari do ta ndihmojë ekipin drejt arrijtjes së objektivit drejt Superligës", thuhet në njoftimin e Drenicës.

Drejtuesit e klubit që bënë gara në Ligën e Parë po punojnë vazhdimisht për ndërtimin e skuadrës për edicionin e ri dhe shumë shpejt priten edhe përforcime të tjera.

Kompletohet ekipi olimpik i xhudos, Kuka: Caku, medalja olimpike

PEJË, 25 QERSHOR - Të martën është konfirmuar mbyllja e kualifikimit për Lojërat Olimpikë që mbahen muajin e ardhshëm. Xhudoja e Kosovës do t'i ketë gjashtë atletë në Olimpiadë, të cilët e kanë

arritur normën olimpik. Akil Gjakova, Distria Krasniqi, Nora Gjakova, Laura Fazliu dhe Loriana Kuka janë xhudistët që do ta përfaqësojnë Kosovën në Paris.

Trajneri Driton Kuka ka thënë se caku do të jetë medalja olimpikë. "Për një ditë të mirë miq... Sot zyrtarisht konfirmohet mbyllja e kualifikimit për Lojëra Olimpikë! Lista e ekipit tonë. Punë e madhe

e përkushtim tash shkojmë tutje. Caku medalja Olimpikë. Do Zoti shpaguehet munda dhe puna e këtij ekipi dhe mbarë federatës tonë me medalje Olimpikë të radhës", ka shkruar Kuka.



Babai i Ardian Ismajlit: Zoti i shkatërroftë të gjithë ata që ta vodhën ëndrrën!

TIRANË, 25 QERSHOR - Babai i Ardian Ismajlit, Ilmi Ismajli, në rrjetet sociale ka hedhur akuza të rënda dhe ka goditur të gjithë ata që ndikuan që mbrojtësi nga Kosova të mos e luajë asnjë minutë në "Euro 2024" me Kombëtaren e Shqipërisë. Trajneri Sylvinho u dha minuta shumicës së

futbollistëve, por mungesa e njërit nga lojtarët kryesorë në secilën nga tri ndeshjet, ishte befasi e madhe. Bëhet fjalë për titullarin e padiskutueshëm të eliminatorëve, Ardian Ismajli, i cili nuk luajti as edhe një minutë në "Euro 2024". "Ardian, bëhu i qëndrueshëm dhe i fort për këtë padrejtësi, për këtë

tradhti, të jeni krenar për çdo gjë që keni dhënë për Kombëtaren sepse e kemi detyrim. Zoti i shkatërroftë të gjithë ata që ta vodhën ëndrrën qysh nga fëmijëria të cilën ma tregoje... Te pabesët, tradhtarët, u munduan ta ndalnin diellin që të mos ndriçoj, por mjeranat nuk e kuptuan se diellin mund

ta ndal vetëm krijuesi i tij. Zoti i shkatërroftë ata që të benë pabesi, të benë tradhti sepse shumë ke besuar dhe nuk keni faj se në ballët e tyre nuk shkruante i pabesë... Je i qetë se ditë të bardha dhe karrierë të madhe jeni duke pritur, është shumë afër...", ka shkruar babai i Ismajlit.



Ankohet trajneri i Kroacisë: Si mund të japësh 8 minuta shtesë?

LEIPZIG, 25 QERSHOR - Kroacisë iu rrëmbye fitorja në 20 sekondat e fundit të ndeshjes kundër Italisë. Zaccagni i ndëshkoi kroatët duke i hequr mundësinë për ta mbyllur në vendin e dytë në Grupin B. Pas sfidës trajneri Zlatko Daliq shpërtheu nga zemërimi dhe u ankua për faktin se arbitri holandez Dani Makelie sinjalizoi 8 minuta shtesë dhe kështu lejoi Italinë të barazonte në momentin e fundit. "Ne jemi të vegjël, një Federatë e vogël, por nuk mund të jepem tetë minuta kohë shtesë. Kjo sigurisht ndikoi në rezultat. Nuk e di nga i mori arbitri ato tetë minuta. Prej pesë vitesh kam folur për mënyrën sesi sillen UEFA dhe FIFA, por askush nuk më ka dëgjuar. Dhe kështu dukesh qesharak. Nuk mund të ketë tetë minuta kohë shtesë. Sa gabime dhe ndërprerje kishte për të plotësuar tetë minuta?", ka thënë Daliq. Trajneri kroat ka pëlqyer të mos flasë më shumë për arbitrin: "Nuk do të jetë justifikim. Kundër Shqipërisë kishim gjithçka në dorë



dhe tani kishim dy penallti dhe i humbëm, por më vjen keq dhe më dhemb që askush nuk na respekton. Ky nuk ishte turneu ynë. Tifozët u shfaqën përsëri, njëqind mijë kroatë erdhën në Gjermani. Faleminderit atyre! Ne jemi krenarë. Por arsyeja pse nuk kemi shkuar më tej është te ne. Nuk mund të pësosh gol në minutën e 98. Duhet ta mbash topin nëse është e nevojshme". I

pyetur për zëvendësimin e Modriqit në momentet e fundit, Daliq është përgjigjur: "Unë thjesht doja të fusja dikë më të freskët sepse Luka kishte dhënë vërtet gjithçka. Ky rezultat dhemb shumë dhe do të dhemb sërish në ditët në vijim, në muajt në vijim. Ndonjëherë fitojmë e herë humbim. Ne ishim në gjendje ta festonim fitoren dhe tani duhet të dimë se si ta pranojmë humbjen".

Arrestohen babë e bir, shantazhuan familjen Schumacher se do të publikonin të dhëna për gjendjen e pilotit

HAMBURG, 25 QERSHOR - Një baba dhe djali i tij qëndrojnë pas tentativës së fundit për shantazh ndaj familjes së ish-kampionit të botës në Formula 1, Michael Schumacher, i cili u lëndua rëndë në një aksident me ski në vitin 2013. Kjo u raportua nga zyra e prokurorisë gjermane në Wuppertal, e cila po e heton rastin. Më parë prokuroria kishte njoftuar vetëm se po hetonte "një rast shantazhi ndaj një personi të famshëm".

Kryeprokurori Wolf Tilman Baumert shtoi se disa urdhër-arreste janë ekzekutuar në lidhje me akuzat, siç raporton "Der Spiegel". Sipas prokurorisë, dy burra të moshës 53 dhe 30 vjeç nga Wuppertal u përpoqën ta shantazhonin familjen e 7 herë kampionit të botës. Të dy pretendonin se posedonin dosje,



publikimi i të cilave nuk do të ishte në interes të familjes. Në këmbim do të kishin kërkuar një shumë prej miliona eurosh, përndryshe të dhënat do të publikoheshin në "darknet". Sipas Prokurorisë, autorët e dyshuar të tentativës së shantazhit i kanë dërguar dosje individuale familjes Schumacher për ta nënvizuar seriozitetin e kërcënimit të tyre. Gjurmueshmëria teknike e këtyre dosjeve çoi më pas

në dyshimin e babait dhe djalit të tij. Dy të dyshuarit kryesorë u arrestuan më 19 qershor në parkingun e një supermarketi në Gross-Gerau, Hesse, dhe aktualisht ndodhen në paraburgim. "Nëse shpallen fajtorë, ata rrezikojnë një gjobë ose dënim me burg deri në pesë vjet", ka thënë kryeprokurori. Kjo nuk është hera e parë që familja Schumacher vihet në shënjestër të kriminelëve. Në vitin 2017 Gjykata e rrethit të Reutlingen dënoi një 25-vjeçar me 21 muaj dënim me kusht për tentativë shantazhi. Burri i kishte kërkuar gruas së Schumacherit 900 mijë euro, me kërcënimin se mund t'u ndodhte diçka fëmijëve të saj. Muajin e kaluar familja e Schumacherit fitoi një veprim ligjor kundër një botuesi reviste që publikoi një intervistë të krijuar me Michael Schumacherin.

Bayerni nxjerr në shitje Comanin, PSG-ja gati të paguajë 50 milionë euro

Kingsley Coman është në listën e lojtarëve që Bayern Muncheni do të largojë nga skuadra këtë verë. Anëtori i majtë francez është me vlerë në duar dhe gati të largohet nga "Bavaria" pas nëntë

vjetësh, ndërkohë që interesimi për të nuk mungon. Paris Saint-Germain, Barcelona dhe një klub ende i paidentifikuar i Premierë Ligës janë të interesuara për anëtorin Kingsley

Coman. Lojtari është aktualisht i grumbulluar me kombëtaren franceze në "Euro 2024". Kontrata e tij me Bayernin është deri në vitin 2027, ndaj klubi gjerman e vlerëson kartonin e lojtarit në

reth 50 milionë euro. PSG-ja duket në "pole" për 28-vjeçarin me origjinë nga Parisi, i cili është rritur në këtë klub. Ardhja e Michael Olise duket se ka nxitur "bavarezët" ta largojnë

mesfushorin francez, që nuk pati një sezon shumë pozitiv me Bayernin. Gjithçka që mbetet për t'u parë nëse edhe Barcelona do të ndërhyjë, por Coman duket se dëshiron rikthimin në vendlindje.

SHKURT

Mustafi përfundon karrierën e futbollistit

Mbrojtësi shqiptar Shkodran Mustafi është pensionuar nga futbollit aktiv. Ish-futbollisti i disa skuadrave të mëdha në Evropë (Sampdoria, Valencia, Arsenal, Schalke dhe Levante), dhe ish-kampioni i botës me Gjermaninë në vitin 2014, do të largohet nga loja aktive, por jo edhe nga futbollit. 32-vjeçari do të nisë një aventurë të re si ndihmëstrajner i Gjermanisë të moshave deri në 17 vjeç. "Kam shumë dëshirë që të punoj me të rinjtë pasi dua që të kaloj atë çfarë kam mësuar në fushë", ka thënë Mustafi.

Modriqi nuk mendon të pensionohet

Pas barazimit 1-1 që Kroacia arriti ndaj Italisë, rezultat që thau se ka eliminuar ekipin ballkanas, mesfushori Luka Modriqi ka folur për të ardhmen e tij. Ai ka deklaruar se nuk ka ndër mend të tërhiqet nga futbollit edhe pse është 38-vjeçar. "Do të vijë edhe momenti kur unë do të detyrohem të tërhiqem nga futbollit, por ende nuk e di se kur do të vijë kjo ditë", u shpreh kroat, që u bë futbollisti më i vjetër në moshë që shënon në një Evropian. "Kjo ishte një nga ndeshjet më të pafat të karrierës time. Kjo është një ditë e trishtë për mua dhe kombëtaren, por unë nuk ndalem këtu. Për momentin do të vazhdoj të luaj, kjo është e sigurt. Dua t'i falënderoj të gjithë për mesazhet dhe përgëzimet", ka shtuar mesfushori, i cili ka rinovuar edhe për një vit me skuadrën e Real Madridit, me të cilën ka fituar titullin dhe Ligën e Kampionëve.

Spalletti: Besuam deri në sekondën e fundit

Italia ia mohoi fitoren Kroacisë, pasi e barazoi rezultatin 1-1 në minutën e 98-të të ndeshjes. Në këtë mënyrë italianët u kualifikua tutje si Kombëtarja e dytë në Grupin B, pas Spanjës. Trajneri Luciano Spalletti ka thënë se besuan deri në sekondën e fundit. "Ne besuam deri në sekondën e fundit. Futbollit është kështu. Ka momente që kthehen në kulm, siç ka edhe momente të vështira", ka thënë Spalletti. Në 1/8 e finales në Euro 2024, Italia do të përballet me Zvicrën.

Reali konfirmon largimin e Nachos

Nacho ka vendosur t'i japë fund karrierës së tij si lojtar i Real Madridit. Lajmin e ka dhënë skuadra mbretërore përmes një komunikate për medie. Nacho mbërriti në Real Madrid në vitin 2001, kur ishte vetëm 10 vjeç, dhe ka luajtur në të gjitha kategoritë e ekipit të rinjve derisa u bë lojtar i ekipit të parë në vitin 2012. Që atëherë ai ka mbrojtur fanellën për 12 sezone të suksesshme në historinë e Real Madridit. Gjatë gjithë kësaj kohe ai ka luajtur 364 ndeshje dhe ka fituar 26 tituj: 6 Liga të Kampionëve, 5 Kupa të Botës për Klube, 4 Superkupa Evropiane, 4 Liga, 2 Kupa të Mbretit dhe 5 Superkupa të Spanjës. Përveç kësaj, me skuadrën spanjolle ai u bë kampion i Evropës në 21 vjeç dhe kampion i Ligës së Kombeve, ndërsa aktualisht po luan në Kampionatin Evropian 2024 në Gjermani. Nacho e mbyll karrierën te Real Madridi si kapiteni që ngriti të pesëmbëdhjetën në "Wembley", si një nga pesë lojtarët që kanë fituar 6 Liga të Kampionëve në të gjithë historinë e futbollit dhe me numrin më të madh të titujve në historinë e klubit nga Madridi.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “SIMPSONS S FOOD” Sh.P.K. me seli në Vushtri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812092394 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “SIMPSONS S FOOD” D.O.O. od Vuçiterna, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812092394 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “SIMPSONS S FOOD” L.L.C. with headquarters Vushtria, has come to the decision to quit its business: 812092394 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “BluberrY-S Group” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810028044 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “BluberrY-S Group” D.O.O. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810028044 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “BluberrY-S Group” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 810028044 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Luan Lekaj Lumbardh KK Deçan shpall të pavlefshme dëftesën e shmu “Lan Selimi” Lumbardh KK Deçan nga kl. 1-5 DHE 6-9.
- Florjana Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Kujtesa Saneja nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e QAMO sh.m.e. “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Djellza Gashi shpall të pavlefshme dëftesëne kl. së dhjetë të Gjmnazit “Ahmet Gashi” Prishtinë.
- Dibran Memedaj shpall te pavlefshme diplomën Q.K “11 Marsi” Prizren.
- Erdi Muhameti shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V shfm “ 28 Nëntori “ Brodosane.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, shpall:

KONKURS

Për zgjedhjen e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit

Sipas Ligjit nr. 05/L -042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, Komisioni Shqyrtues përbëhet nga kryesuesi i zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, një anëtar i emëruar nga Autoriteti dhe një anëtar i emëruar nga ofruesi i shërbimeve, i cili ka parashtruar kërkesën për shqyrtim. Kryesuesi i Komisionit Shqyrtues zgjedhet për mandat tre (3) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes vetëm edhe për një mandat.

Kandidati për kryesues të Komisionit Shqyrtues duhet të plotësojë kushtet si në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- të ketë së paku diplomë universiteti katër (4) vjeçar ose master;
- të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale, mbi gjashtë (6) muaj burgim;
- të ketë integritet të lartë moral;
- të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale;
- Letra motivuese;
- Curriculum Vitae (CV - autobiografia);
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale.

PROCEDURA E KONKURRIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 10 korrik 2024, në orën 16:00.

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:
Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtoria për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Zyra N-217).

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

Forma elektronike: faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 200-10411, 038 200-10410 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara. Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština Republike Kosovo raspisuje:

KONKURS

Za izbor predsedavajućeg Komisije za razmatranje pri Regulatornom autoritetu za usluge voda

Prema Zakonu br. 05/L -042 o regulisanju usluga voda, Komisija za razmatranje se sastoji od predsedavajućeg, izabranog od strane Skupštine Republike Kosova, jednog člana imenovanog od strane Autoriteta i jednog člana imenovanog od strane pružioča usluga koji je podneo zahtev za razmatranje. Predsedavajući Komisije za razmatranje bira se za mandat od tri (3) godine, uz mogućnost ponovnog izbora za samo još jedan mandat.

Kandidat za predsedavajućeg Komisije za razmatranje treba da ispunjava sledeće uslove:

- da je državljanin Republike Kosova;
- da ima najmanje četvorogodišnju (4) univerzitetsku diplomu ili master;
- da nije bio osuđivan za krivična dela, preko šest (6) meseci zatvora;
- da ima visoki moralni integritet;
- da ima najmanje tri (3) godine radnog iskustva u profesiji.

Aplikaciji treba priložiti sledeća dokumenta:

- Dokaz o školskoj i stručnoj spremi;
- Motivaciono pismo;
- Curriculum Vitae (CV - autobiografija);
- Dokaz o državljanstvu Republike Kosova;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Dokaz da nije osuđen za krivično djelo.

PROCEDURA KONKURISANJA

Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 10. jul 2024. godine u 16.00 časova.

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu:
Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija za upravljanje ljudskim resursima, Kancelarija N-217).

Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:

Štampana forma: u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul. „Majka Tereza“ bb. ili u

Elektronskom obliku: internet-stranica Skupštine Republike Kosova - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana u 16:00 časova, na brojeve telefona: 038 200-10411, 038 200-10410 dhe 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta. Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažecim.



TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

